



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
REKTORATI

Nr. 1012/4 Prot

Durrës, më: 22.04.2026

V E N D I M

Nr. 6, datë 22.04 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së, në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të UAMD-së; në relacionin e grupit të punës nr.510/4prot., datë 30.03.2026; në shkresën e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike nr.780 prot., datë 31.03.2026, si dhe në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave nr.840 prot., datë 07.04.2026, në mbledhjen e datës 22.04.2026, Rektorati,

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Drejtuesve të Njësive Kryesore dhe Drejtorisë së Kurrikulës Cilësisë dhe Statistikave, për hartimin e një plani pune për monitorimin e procesit mësimor nga e hëna deri të dielën, duke zbatuar Rregulloren e UAMD-së, **brenda datës 24.04.2026;**
2. Ngarkimin e Drejtuesve të Njësive Kryesore të FSP dhe FTI, për përcjelljen e një relacioni të detajuar mbi vijueshmërinë e punës për hapjen e programeve duale / të përbashkëta, me Universitetin e Ankonës, Universitetin e Barit etj., (vendimet e marra, mendimin e Njësive Bazë ngritjen e grupit të punës nga Dekani, korrespondencën me universitetet partnere, problematikat, afatet e vendosura etj.), **brenda datës 23.04.2026;**
3. Miratimin paraprak të Kornizës (Framework) Institucionale për hapjen dhe Organizimin e programeve me diplomë të dyfishtë (double degree program) dhe të përbashkët (joint degree program), në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe kalimin për miratim përfundimtar në Senatin Akademik;
4. Miratimin e periudhës zgjedhore për anëtarë të Këshillave Studentorë të fakulteteve dhe Këshillit Studentor të universitetit nga data 22.04.2026 deri me datë 22.05.2026 dhe ngarkimin e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Studentore për marrjen e masave për ndjekjen dhe organizimin e procesit të zgjedhjeve;
5. Ngarkimin e Administratorit, Zv. Rektorët, Drejtuesve të Njësive Kryesore dhe Drejtorët e Drejtorive, lidhur me shkresën nr. 840 prot., datë 07.04.2026 "Relacion mbi analizën e rezultateve të pyetësorit për vlerësimin e shërbimeve të ofruara nga stafi ndihmës akademik dhe administrativ për studentët e UAMD-së", për hartimin e një

plani për përmirësimin e kushteve sipas problematikave të nxjerra nga pyetësi,
brenda datës 30.04.2026.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Administratori
- Zv. Rektorët
- Drejtuesit e Njësive Kryesore
- Drejtorët e Drejtorive

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTOR

Prof.Dr. Shkëlqim Fortuzi

